

Në bazë të nenit 59 të Ligjit për rregullimin e hapësirës dhe ndërtimin e objekteve ("Fl. zyr. MZ", nr. 51/08, 40/10, 34/11, 47/11, 35/13, 39/13 dhe 33/14), nenit 34, paragrafi 1 dhe 3 dhe nenit 40, paragrafi 2, pika 3 të Ligjit për pronën shtetërore ("Fl. zyr. MZ", nr. 21/09 dhe 40/11), nenit 28 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për marrëdhëniet pronësore juridike ("Fl. zyr. MZ", nr. 19/09), nenit 33 paragrafi 1 pika 1 dhe nenit 45 paragrafi 1 pika 9 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Fl. zyr. RMZ", nr. 42/03, 28/04, 75/05, 13/06 dhe "Fl. zyr. MZ", nr. 88/09, 3/10, 38/12, 10/14 dhe 57/14) dhe nenit 36, paragrafi 2 dhe 3 dhe nenit 42, paragrafi 1 pika 9 të Statutit të Komunës së Ulqinit ("Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës", nr. 5/07, 9/09 dhe 16/11), Kuvendi i Komunës së Ulqinit në mbledhjen e mbajtur, më 11. 07. 2018, ka nxjerrë

V E N D I M I N

për blerjen e tokës me qëllim të kompletimit të parcelës urbanistike nr. 98 nga ID PDU "Ulqini – Qyteti" për lokalitetin "Kodra 1" Komuna e Ulqinit

Neni 1

I lejohej Ruzhdi C. Ravjes blerja e parcelës kadastrale nr. 5413/3 me sipërfaqe prej 24 m² nga F.P. nr. 604 KK Ulqin, parc. kad. nr. 7501/8 me sipërfaqe prej 64 m² nga F.P. nr. 4854 KK Ulqin, si pronë e Malit të Zi – bartës i të drejtës së disponimit Komuna e Ulqinit, me qëllim të kompletimit të parcelës urbanistike nr. 98, e formuar me Ndryshimet dhe plotësimet e PDU "Ulqini – Qyteti" për lokalitetin "Kodra 1".

Neni 2

Parcela urbanistike e përmendur në nenin 1 të këtij Vendimi përbëhet prej parcelave kadastrale të cilat janë subjekt i blerjes, një pjesë e parcelës kadastrale nr. 5411/3, nga F.P. nr. 3489 pronësi ee Ravja C. Ruzhdos prej 501 m² dhe njëpjesë e parcelës kadastrale nr. 5411/4 nga F.P. nr. 3489 KK Ulqin – pronësi 1/1 e Ravja C. Ruzhdos me sipërfaqe prej 204 m².

Neni 3

Patundshmëria nga neni 1 i këtij Vendimi blehet me kompensim në shumën prej 200,00 € për 1 m², që në total është 17.600,00 €.

Kompensimi në shumën e përmendur është caktuar nga ana e Marniković Vinko ekonomist vlerësuesit të autorizuar për vlerësimin e vlerës së patundshmërive në territorin e Komunës së Ulqinit, nr.15/18 datë 22. 03. 2018.

Neni 4

Autorizohet Kryetari i Komunës së Ulqinit që me Ruzhdo C. Ravjen të lidhë kontratë për shitblerjen e patundshmërisë nga neni 1 i këtij Vendimi, me të cilën do të rregullohen të gjitha të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

Neni 5

Personi nga neni 1 i këtij Vendimi e fiton të drejtën e regjistrimit të drejtës së pronësisë në patundshmëri tek Drejtoria për patundshmëri të Malit të Zi – Njësia rajonale Ulqin, pas shlyerjes së obligimit të kontraktuar.

Nëse personi nga paragrafi 1 i këtij neni në afat prej 6 (gjashtë) muajsh nuk e lidhë kontratën nga neni 4 i këtij Vendimi dhe nuk i shlyen detyrimet ky Vendim pushon së qeni i vlefshëm.

Neni 6

Palët shprehimisht autorizojnë Sekretariatën për mbrojtjen e pasurisë që mund të bëjë përmirësime, por vetëm dhe ekskluzivisht të atyre që kanë dalë me rastin e daktilografimit të këtij Vendimi

Neni 6

Tatimin në qarkullim të patundshmërisë e paguan blerësi.

Neni 7

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e tetë pas botimit në Fletoren zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës.

Numër: 02-130/18-8

Ulqin, më 11. 07. 2018

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

KRYETARI

Dr. Ilir Çapuni, d.v.